

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "BATI BAKERY & PASTRY" Sh.p.k.

Sot, me datë 01 / 02 /2024,

Shoqëria "**B A T I**" shpk e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NUIS: **M12110001J**, me adrese ne Njesine Bashkiake Nr. 2, Bulevardi Zhan Dark, njesia me nr. pasurie 5/532+2+-N9, zone kadastrale nr.8150, volum 49, faqe 53, siperfaqe 108 m2, ne krah te Ministrise se Puneve te Jashtme, me perfaqesues ligjor: **Z. Mariglen Gjata**, shtetas shqiptar, atësia Genci, lindur më 03.10.1995, në Tiranë, banues në: Bejte Bulticë 0400011; Nd 5, H 1, Bejte, Bulticë, Vaqarr, Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 031451156 me ID J51003115P, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**BATI BAKERY & PASTRY**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**BATI BAKERY & PASTRY**"

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Mine Peza, Zone Kadastrale Nr. 8350, Volumi 42, Nr.pasurie 3/198+1-, Tirane**

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Perpunim dhe prodhim i produkteve te bukes dhe te brumit, perpunim dhe prodhim pasta, embelsire, sherbime katering, ushqim social, sherbime kulinari, gurme, Delivery (shperndarje ne adrese te porositesit), sherbime ne fushen e bar kafe restorant, menaxhim ne fushen e bar-restoranteve, bar kafe, veprimtari ne fushen e turizmit, organizim eventesh, konsulence ne fushen e bar restoranteve, pergatitje stafi per bar restorante, etj. Ne pergjithesi subjekti mund te kryeje cdo veprimtari te nevojshme e te dobishme te lejuar nga ligji, per realizimin e objektit te aktivitetit te saj. Subjekti mundet gjithashtu te ushtroje cdo lloj tjetër biznesi apo aktiviteti te ligjshem dhe/ose mund te angazhohet ne cdo veprimtari te ligjshme ose aktivitet te lejueshem nga legjislacioni shqiptar nr fuqi



NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 100.000 (një qind mijë) Lekë dhe përbëhet nga 1 (nje) kuotë.

Kapitali themeltar përbëhet si më poshtë:

-**Shoqeria B A T I shpk**, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe 100.000 (njëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

-Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

-Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **z. Klejvis Selimja**, shtetas shqiptar, lindur më 28.09.2002, në Tiranë, banues në: Tirane, mbajtës i dokumentit pasaporte me nr. BE4111981 me ID K20928042Q, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar Administratorin, **Z. Mariglen Gjata**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

“B A T I” shpk

Perfaqesuar nga

MARIGLEN GJATA

